

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
	Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>	Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 1/4</b>

*PSB, 24.11.2021*

**Titulli i DPS/KT:**

**DPS/KT 19 “Produkte nafte, lubrifikantë dhe produkte që lidhen me to”**

## **PËRMBLEDHËSE E PËRGJITHËTHËSHME**

Komiteti Teknik 19, në Drejtorinë e Përgjithëshme të Standardizimit, adopton standarde evropiane dhe ndërkombëtare si dhe harton standarde puro shqiptare SSH për industrinë e shitjes dhe shpërndarjes të naftës dhe të produktet që rrjedhin nga përpunimi i këtyre materialeve natyrore. Standardet përfshijnë ato fusha që përcaktojnë cilësinë e produktit, metodat e analizave, marjen e mostrave si dhe ato për një monitorim të sistemit të cilësisë për karburantet.

Tregu i lëndëve djegëse në Evropë dhe në Shqipëri po shkon gjithmonë e më tepër drejt normalizimit. Shtimi gjithnjë e më shumë i makinave dhe i nevojave në ritje për energji (për ngrohje, elektricitet) ka çuar në ritjen e kërkesës për këto lëndë djegëse, por për shkak të masave të reduktimit të energjisë dhe të futjes së energjisë alternative në treg, sasia e prodhimit të lëndëve djegëse është ritur pak. Nga ana tjetër një vëmendje gjithnjë e më e madhe i kushtohet prodhimit të biokarburanteve. Të gjitha këto kërkesa të reja shkaktojnë një lëvizje të vazhdueshme në treg dhe mbi të gjitha në punën e KT 19.

Që nga krijimi i tij KT 19 ka punuar për standardizimin e tregut të karburanteve në shqipëri. E gjithë kjo ka shërbyer për të mbështetur kërkesat e sektorit (të sigurisë, të metodave të sakta të provave) në njërin anë dhe nevojave të vendit (cilësia karburantet, emetimet, lejimi i biokarburanteve) në anën tjetër. Më shumë se gjysma e standardeve të saj janë të lidhura direkt me direktivat e KE-së.

Objektivat kryesorë të KT 19 janë:

- të japë, në veçanti për palët e interesuara, një platformë diskutimi për standardizimin e çdo fushe të sektorit si dhe implementimin dhe përdorimin e standardeve;
- të miratojë të gjitha standardet evropiane dhe ndërkombëtare të fushës që mbulon pa patur kërkesë të veçantë nga ana e tyre duke mbajtur parasysh kërkesat e vëndit, dhe në veçanti standardet specifike për industrinë automobilistike (bio-karburantet);
- të adoptojë 100% standardet evropiane të lëndëve djegëse për të përmbushur detyrimin për pranimin me të drejta të plota në CEN;
- të ndjekë dhe të marrë pjesë aktive në punën e Komitetit Teknik të CEN me ane të afrimit të specialistëve të saj në punën e këtij KT

### **1. Mjedisi i Biznesit i KT/DPS**

#### **1.1 Përshkrimi i mjedisit të biznesit**

Dinamikat e politikave të ndjekura, ekonomike, teknike, regullatore, ligjore dhe sociale përshkruajnë mjedisin e biznesit në sektorin industrial, atë të produkteve, materialeve, disiplinës ose praktikave që kanë të bëjnë me qëllimin e këtij KT. Ato gjithashtu mund të ndikojnë se si janë kryer proceset e hartimit të standardeve të rëndësishëm.

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
	Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>	Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 2/4</b>

Produktet e naftës në përgjithësi janë produkte të konsumit të gjërë , të tregëtuara në sasi të mëdha në të gjithë botën. Duke u bazuar në pritshmërinë dhe në trendin aktual të shitjes dhe shpërndarjes të biznesit të naftës, Komiteti Teknik 19 parashikon që ky biznes të jetë gjithmonë në ndryshim duke i kushtuar një vëmendje të vacantë cilësisë së produktit dhe ndotjes së mjedisit si një shtysë drejt uljes së kostos.

Aktorët kryesore në treg janë:

- Industria e shitjes dhe shpërndarjes së naftës;
- Blerësit/përdoruesit e produkteve të naftës;
- industritë që kanë lidhje me fusha të ndryshme të aplikimit të produkteve të naftës, p.sh. industria e makinave dhe motorave, industria e ndërtimit të rrugëve, institucionet qeveritare, laboratorët e pavarur dhe etj.;

Me ritjen e interesit për të ashtuquajturit motor me lëndë djegëse alternative ose te avancuar këtij biznesi i shtohen në treg edhe prodhuesit e (bio) etanolit dhe FAME (biodieselit). Këto produkte të reja shpesh quhen gjenerata e dytë e biofulseve që dal ngadalë po futen në treg.

Në tregëtimin, trajtimin dhe zbatimin e produkteve të naftës, shëndeti, siguria dhe aspektet mjedisore, shpesh të mbështetura nga masat rregullatore luajnë një rol gjithmonë e më të madh për hartimin e standardeve të reja si dhe për rishikimin e atyre ekzistues

Zhvillimet në fushën e sigurimit të cilësisë dhe menaxhimit të cilësisë gjithashtu bën thirrje për standarde të reja dhe përmirësimin e standardeve ekzistuese, në veçanti në lidhje me gjurmueshmërinë e rezultateve të testit dhe ripërsëritshmërisë dhe riprodhueshmërisë e metodave të testimit.

### 3. Tregtimi

#### a) Tregtimi me shumice

Ne vend jane licensuar mbi 150 shoqeri te tregtimit me shumice te karburanteve. Sidoqofte, mbi 80% e tregut zoterohet nga me pak se 10 shoqeri, duke pasqyruar keshtu shenja te nje perqendrimi te larte. Ne Shqiperi lejohet shkarkimi i karburanteve me anije vetem ne Portin e Portoromanos ne Durres dhe Petroliferes ne Vlore. Ketu jane perqendruar dhe shoqerite kryesore, te cilat kane ndertuar terminalet e tyre. Shitja me shumice e karburanteve eshte e kontrolluar nepermjet pajisjeve fiskale. Transporti me anije ze rreth 95% te transportit total, ndersa pjese tjeter realizohet me autobote.

#### b) Tregtimi me pakice

Ne Shqiperi jane licensuar mbi 950 pika karburanti, te cilat jane shperndare ne te gjithe vendin. Pjesa me e madhe eshte e perqendruar ne zonen Durres - Tirane, e ndjekur nga qytetet e medha si Fieri etj. Gjithashtu operojne disa pika karburanti te palicensuara ne zonat rurale. Shitja me pakice e karburanteve eshte e kontrolluar nepermjet pajisjeve fiskale. Rreth 50% e pikave te karburantit jane te "bardha", pra nuk jane pjese e rrjeteve te shoqerive te njohura te tregtimit me shumice

## 2. PËRFITIMET E PRITËSHME NGA PUNA E KT/DPS

Standardet e kësaj fushe nevojiten për të lehtësuar tregtinë rajonale dhe botërore të produkteve të naftës. Ato ndihmojnë për:



- mënjanimin e mosmarveshjeve midis palëve duke përdorur një terminologji të përbashkët;
- mënjanimin e keqinterpretimeve duke përdorur metoda të njëjta prove dhe marje mostre në vlerësimin e cilësisë së produktit;
- përdorimin e metodave të njëjtja matjeje për të evituar provat e dyfishta;
- klasifikimin e produkteve dhe specifikimeve të tij për të patur një document referues në dispozicion të publikut sesa një kontratë individuale ndërmjet furnizuesit dhe blerësit;
- të patur procedura të përbashkëta operacionale për të shmangur dallimet në kontrollimin e cilësisë së një produkti;
- ti dhënë konsumatorit një produkt të sigurt me anë të metodave të sakta provash në lidhje me pikën e ngrirjes, pikën e flakërimit atë të avullshmërisë etj.;
- të ndihmuar entet e specializuara kombëtare për hartimin e rregullave teknike në fushen që mbulon ky KT.

### **3 PJESMARJA NË KT/DPS**

Të gjitha palët e interesuara në procesin e hartimit dhe të zbatimit të standardit kanë të drejtë që të caktojnë ekspertët e tyre në KT të DPS si dhe në Grupet e Punës të ngritura për çështje të veçanta në mënyrë që të arihet një balancë sa më e mirë për të gjithë palët e interesuara.

### **4 OBJEKTIVAT E KT/DPS DHE STRATEGJITË PËR TË ARDHMEN**

#### **4.1 Objektivat e përcaktuara të KT/DPS**

Bazuar në konsideratat e mësipërme si dhe në detyrimin që ka DPS për tu antarsuar me të drejta të plota në CEN, KT/DPS propozon objektivat dhe drejtimet strategjike për punën e saj të ardhshme:

- të sigurojë, për palët e interesuara, një platform të gjërë diskutimi mbi standardizimin e çdo fushe dhe sektori si dhe implementimin dhe zbatimin e standardeve evropiane;
- të adoptojë të gjitha standardet evropiane të lëndëve djegëse (bio) për automjete në vartësi të Direktivës 98/70/EC për Cilësinë e Lëndëve Djegëse si dhe të Direktivës së Energjisë së Rinovueshme;
- të rishikojë standardet puro shqiptare të lëndëve djegëse për ngrohje dhe përdorim shtëpiak për ti afruar ato me standardet evropiane;
- të mirmbajë dhe plotësojë databazin e DPS duke shtuar edhe qëllimin e standardit.
- Të gjeje mënyra dhe mjete alternative për përkthimin e standardeve SH EN 590, S SH EN 589 dhe S SH EN 228 në shqip dhe ti adoptojë ato me përkthim të plotë.

#### **4.2 Identifikimi i strategjive për aritjen e objektivave të KT/DPS**

Përmbushja e objektivave të KT 19 bazohet në punën për adoptimin e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare, duke bashkëpunuar me KT "pasqyrë" të CEN dhe ISO si më poshtë:

CEN/TC 12 - Materials, equipment and offshore structures for petroleum, petrochemical and natural gas industries.


CEN/TC 19 - Gaseous and liquid fuels, lubricants and related products of petroleum, synthetic and biological origin.

CEN/TC 47 - Atomizing oil burners and their components - Function - Safety – Testing.

CEN/TC 108 - Sealing materials and lubricants for gas appliances and gas equip.

CEN/TC 109 - Central heating boilers using gaseous fuels.

CEN/TC 131 - Gas burners using fans.

	Emri i institucionit: <b>DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT</b>	Dokumenti Nr.: <b>RC/DS/117</b>	
Titulli: <b>Plani strategjik i biznesit për DPS/KT</b>		Versioni: <b>01</b>	Faqe Nr.: <b>Faqe 4/4</b>

CEN/TC 181 - Dedicated liquefied petroleum gas appliances.  
 CEN/TC 281 - Appliances, solid fuels and firelighters for barbecuing.  
 CEN/TC 317 - Derivatives from coal pyrolysis.  
 CEN/TC 335 - Solid biofuels.  
 CEN/TC 343 - Solid Recovered Fuels.  
 ISO/TC 28 - Petroleum products and lubricants

**Sekretari i DPS/KT 19**

**(Pëllumb METOHU)**